

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Tirana - Adresa - Address

06/40/ 212-12/2024  
21.05.24

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Department

DATË	21.05.2024
REFERENCË	Nv- 75/2024
PËR/ZA/TO:	Z. Nuhi Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionit i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar

I nderuari z. Mani,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Departamenti i Buxhetit paraqet:

#### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen e Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar.

## OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky projektligj ka kosto totale prej 40,000,000\$ për vitin 2024 (bazuar në kursin valutor të datës 21.05.2024 është në shumë prej 36,800,000 euro (1\$=0.92€)).


### Përfundim:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk ka kosto shtesë buxhetore.

Kredia e parapare me këtë Marrëveshje është pjesë e Ligjit me Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026, përkatësisht është pjesë e tabelës 1.1. Financimi i bilancit buxhetor, përkatësisht kolona 2.1 Pranimet: Financim Direkt Buxhetor-FMN, BB, BE, etj

Përgatitur nga:

Antigona Bekaj, Analiste e lartë e buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

